REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE
Nr.Br.Nr: 01-128012
Data/Datum/Date: 26/11/2026
Shtojca/Dodatci/Annex -2-
PRISHTINË/A

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria – Vlada – Government*
*Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice*
*Kabineti i Ministres së Drejtësisë – Ured Ministarke Pravde – Office of the Minister of Justice*

---

Nr. 315 /2026
Datë: 26/11/2026

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura në përputhje me nenin 10, nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi1.5) të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 35 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtaret Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-294 për Zyrtaret Publik dhe nenin 53 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në pajtim me nenin 6 të Rregullores (QRK)-Nr.08/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Zëvendëskryeministrja dhe Ministrja e Drejtësisë, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Z. Fitim Bërbatovci, Mbikëqyrës i Lartë në Qendrën Korrektuese në Lipjan, caktohet ushtrues detyre i Kryeinspektorit në Inspektoratin e Ministrisë së Drejtësisë.

2. Ushtruesi i detyrës i caktuar në pikë 1 të këtij vendimi, obligohet që detyrat dhe përgjegjësitë e tij t'i kryejë në pajtim me legjislacionin në fuqi.

3. Obligohet Divizioni i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendim, shfuqizohet Vendimi Nr. 326/2025, i datës 29.07.2025 për caktimin e ushtruesit të detyrës së Kryeinspektorit të Inspektoratit në Ministrinë e Drejtësisë.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe vlen deri në përfundimin e procedurave të rekrutimit por jo më gjatë se dymbëdhjetë (12) muaj.

**A r s y e t i m**

Duke marrë parasysh rolin dhe rëndësinë e Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë në ushtrimin e funksioneve të inspektimit dhe mbikëqyrjes, si dhe nevojën për ngritjen e nivelit të performancës institucionale, forcimin e llogaridhënies dhe përgjegjësisë menaxheriale, është vlerësuar e domosdoshme ndërmarrja e masave organizative dhe menaxheriale për garantimin e funksionimit të rregullt, efikas dhe të pandërprerë të Inspektoratit.

Duke pasur parasysh natyrën specifike të veprimtarisë së Inspektoratit, prioritet mbetet rritja e efikasitetit në realizimin e detyrave dhe përgjegjësive ligjore, avancimi i standardeve profesionale të inspektimit, forcimi i mekanizmave të mbikëqyrjes dhe kontrollit, identifikimi dhe adresimi

me kohë i parregullsive eventuale, monitorimi i zbatimit të rekomandimeve, si dhe shfrytëzimi efikas i kapaciteteve njerëzore dhe profesionale në dispozicion.

Në këtë drejtim, duke marrë parasysh përvojën profesionale dhe menaxheriale të z. Bërbatovci, të fituar gjatë ushtrimit të detyrave në pozitën e Mbikëqyrësit të Lartë, të Zëvendësdrejtorit në Qendrën Korrektuese në Lipjan, si dhe të ushtruesit të detyrës së Drejtorit në Qendrën Korrektuese dhe Qendrën Edukuese Korrektuese për të Mitur në Lipjan, është vlerësuar se përvoja e tij në udhëheqjen, organizimin, mbikëqyrjen dhe menaxhimin e proceseve institucionale përbën një element të rëndësishëm për ushtrimin e përgjegjësive drejtuese në Inspektoratin e Ministrisë së Drejtësisë. Me rastin e vlerësimit të përvojës së tij drejtuese, është marrë në konsideratë edhe Vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me nr. A.nr.1420/2025, i datës 04.12.2025.

Caktimi i ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Inspektoratit nuk synon vetëm garantimin e vazhdimësisë institucionale, por edhe përmirësimin e matshëm të performancës, avancimin e standardeve të menaxhimit dhe inspektimit, forcimin e disiplinës organizative, objektivitetit dhe paanshmërisë në ushtrimin e funksioneve inspektuese, si dhe sigurimin e një sistemi efektiv të raportimit, monitorimit dhe llogaridhënies.

Për këto arsye, duke marrë parasysh përvojën profesionale dhe drejtuese të z. Bërbatovci, si dhe nevojën për garantimin e vazhdimësisë dhe përmirësimin e funksionimit të Inspektoratit, është vlerësuar i nevojshëm caktimi i tij si ushtrues i detyrës së Drejtorit të Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë, deri në plotësimin e kësaj pozite përmes procedurës së rekrutimit, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Andaj, bazuar në legjislacionin përkatës në fuqi dhe në arsyet e lartcekura, është vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

**Donika Gërvalla - Schwarz**

**Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Drejtësisë**

Vendimi u dërgohet:

- *Z. Fitim Berbatovci;*
- *Z. Muamer Bikliqi;*
- *Kabinetit të Zëvendëskryeministres dhe Ministres së Drejtësisë;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Instituti i Mjekësisë Ligjore;*
- *Departamentit për Buxhet dhe Financa;*
- *Divizionit për Burime Njerëzore;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*